




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS
KRYETARI I KOMUNËS



Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 17.05.2018, dhe të nenit 9 të Rregullores së MF- së- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ- ve, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për caktimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për subvencione, në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- II. Komisioni i cekur në pikën I të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 1. Drita Rudi, kryesuese;
 2. Munish Hyseni, anëtar;
 3. Valdet Rama, anëtar;
 4. Blerim Ajeti, (anëtar rezervë);
- III. Detyrë e komisionit të cekur në pikën II të këtij Vendimi është që të mblidhet sa herë që paraqitet nevoja dhe të shqyrtojë ankesat ndaj vendimeve për mos kualifikim si rezultat i mospërmbushjes së kriterëve procedurale të parapara me nenet 10 dhe 11 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe ankesat ndaj vendimit për ndarje të mbështetjes financiare, në procesin e përzgjedhjes së përfituesve të mbështetjes financiare.
- IV. Mandati i komisionit të cekur në pikën II të këtij Vendimi është 2 vjeçar.
- V. Për kryerjen e këtyre detyrave të cekura në pikën III të këtij Vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U dorëzohet:

- Anëtarëve;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.



KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti